



## UDHËZUES PËR APLIKANTËT – ORGANIZATAT RINORE DHE/OSE ORGANIZATAT PËR TË RINJTË NË KUADËR TË THIRRJES PUBLIKE PËR PROJEKT-PROPOZIME

Agjencia Kombëtare e Rinisë (AKR) krijuar në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.75/2019 “Për rininë”, VKM nr. 681, datë 02.09.2020 “Për mënyrën e krijimit, të organizimit e të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Rinisë” duke u bazuar në VKM nr.566 datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e kriterëve dhe të procedurave të përzgjedhjes së organizatave rinore, organizatave për të rinjtë, që përfitojnë financim nga fondet grant nga buxheti i shtetit të dedikuar për rininë”, financon projektet e propozuara nga organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë që i referohen prioritetëve rinore të cilave i përmbahet kjo thirrje.

Përcaktimi i prioritetëve për Thirrjen e Tretë bazohet në politikat e Qeverisë për Rininë, prioritetet e Strategjisë Kombëtare për Rininë 2022-29, analizën e situatës së të rinjve për vitin 2023 si dhe konsultimet e bëra me Këshillin Kombëtar të Rinisë (KKR).

Qëllimi i këtij udhëzuesi është të ofrojë këshilla të qarta dhe koncize për të gjitha organizatat e interesuara në procesin e përgatitjes dhe dorëzimit të projekt-propozimeve në kuadër të Thirrjes Publike Nr.3 të AKR-së për organizatat rinore dhe organizatat për të rinjtë.

### 1. SYNIMI I PËRGJITHSHËM I THIRRJES PUBLIKE PËR PROJEKT PROPOZIME DHE PËRPARËSITË

Qeveria e Shqipërisë e shikon situatën me të rinjtë si një mundësi për zhvillim dhe vënien e rinisë në qendër të zhvillimit të vendit. Ligji 75/2019 “Për Rininë” dhe aktet nënligjore të miratuara në mbështetje dhe për zbatim të tij kanë plotësuar kuadrin e nevojshëm rregullator dhe institucional për mbrojtjen dhe zhvillimin e drejtave të të rinjve shqiptarë në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe mbështetjen e zhvillimit të mëtejshëm të ekosistemit rinor.

Miratimi nga Këshilli i Ministrave në Tetor 2022 i Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029 dhe planit të saj të veprimit, ka hedhur bazat për veprim të programuar dhe të qëndrueshëm për mbrojtjen, përfshirjen dhe fuqizimin e të rinjve në Shqipëri. Strategjia ka përcaktuar 3 qëllime politike, 9 objektiva specifike, 44 masa të zërthyera më tej në nën aktivitete, të cilat shoqërohen me parashikimet e institucioneve përgjegjëse, buxhetin mbështetës, afatet dhe pasaportën e indikatorëve për të siguruar cilësinë dhe llogaridhënien në realizmin e tyre. Në dokumentin e strategjisë përcaktohet [...] *Politika kombëtare e strategjisë së rinisë dhe përpjekjet programuese përqendrohen në sigurimin e barazisë së mundësive dhe të drejtave, mbështetjes dhe angazhimit për të rejtat dhe të rinjtë që janë më të prekshëm, të marginalizuar dhe më të goditur nga mungesat e shumta, të tilla si varfëria, dhuna, keqtrajtimi, paaftësia dhe përjashtimi social. [...].* duke vendosur zvogëlimin e pabarazive dhe filozofinë e zhvillimit të vendit që nuk lë asnjë të re apo të ri pas si baza e orientimit dhe angazhimeve të saj. ***Në këtë linjë organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë inkurajohen në formulimin e ndërhyrjeve që adresojnë***

***problematikat e të rinjve shqiptar që janë aktualisht më të cënueshëm, të marginalizuar dhe të goditur nga mungesat.***

Në funksion të zbatimit të Strategjisë Kombëtare për Rininë 2022–2029 dhe bazuar mbi vlerësimin e nevojave të të rinjve, Thirrja Publike Nr.3 synon aktivizimin, përfshirjen dhe mbështetjen e të rinjve në Shqipëri dhe adresimin e problemeve me të cilat ato përballen e që lidhen me sfida si përfshirja në proceset vendimmarrëse, punësimi dhe edukimi duke synuar mundësitë më të vlefshme në tregun e punës, si edhe adresimin e problematikave të cilat lidhen me mirëqenien aktive, të shëndetshme, sociale, fizike, kulturore dhe emocionale të të rinjve.

Organizatat rinore dhe organizatat për të rinjtë janë aktorë thelbësorë që veprojnë në territor dhe që shërbejnë për të mbështetur mbrojtjen dhe avancimin e të drejtave të të rinjve, shpeshherë përtej veprimtarisë së institucioneve shtetërore.

Neni 11 i Ligjit për Rininë, përcakton cilat janë organizata rinore, konkretisht si vijon:

*“Organizatrat rinore janë persona juridikë jofitimprurës, që krijohen dhe funksionojnë në bazë të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe të legjislacionit në fuqi për organizatat jofitimprurëse.*

*Organizatrat rinore duhet të përmbushin këto kritere:*

- a) të jenë të regjistruara në përputhje me legjislacionin në fuqi për organizatat jofitimprurëse;*
- b) të kenë si objekt të veprimtarisë së tyre të parashikuar në statutin e organizatës aktivitete dhe veprimtari rinore;*
- c) të paktën, 70 përqind e anëtarëve të saj të jenë të rinj.”*

Neni 12 i Ligjit për Rininë, përcakton cilat janë organizata për të rinjtë konkretisht si vijon:

*“Organizatrat për të rinjtë janë persona juridikë jofitimprurës, që krijohen e funksionojnë në bazë të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe legjislacionit në fuqi për organizatat jofitimprurëse.*

*Organizatrat për të rinjtë duhet të përmbushin këto kritere:*

- a) të jenë të regjistruara në përputhje me legjislacionin në fuqi për organizatat jofitimprurëse;*
- b) të kenë si objekt të veprimtarisë së tyre të parashikuar në statutin e organizatës aktivitete dhe veprimtari rinore;*
- c) të kenë zbatuar, të paktën për një periudhë 3- vjeçare në mënyrë të vazhdueshme projekte e programe me impakt te të rinjtë.”*

Vendimi Nr. 566, datë 20.7.2022 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e kritereve dhe të procedurave të përzgjedhjes të organizatave rinore dhe organizatave për të rinjtë që përfitojnë financime nga fondet grant nga buxheti i shtetit, të dedikuara për rininë”, parashikon që thirrjet konkurruese për projektpropozime nga organizatat rinore dhe për të rinjtë bazohen mbi analizën e mundësive dhe problematikave për rininë, që adresojnë nevojat dhe prioritetet përcaktuar në strategjitë, planet e veprimit, politikat e programet qendrore dhe vendore për Rininë.

Në përfundim të procesit të analizës së problematikave dhe nevojave për rininë dhe pas konsultimit me Këshillin Kombëtar të Rinisë, Thirrja e Tretë e Agjencisë Kombëtare të Rinisë, synon të adresojë prioritetet e Strategjisë Kombëtare të Rinisë 2022-2029.

Për sa më sipër, AKR fton të gjitha organizatat rinore dhe/ose për të rinjtë në Shqipëri që të paraqesin projekt-propozime që mbështesin objektivat dhe fushat e përparësisë për rininë si më poshtë:

**Fusha e përparësisë nr 1:** Nxitja pjesëmarrjes së të rinjve në proceset vendimmarrëse dhe mbështetja e aktivizimit shoqëror dhe qytetar të tyre.

Kjo fushë përparësie përfshin nxitjen e pjesëmarrjes së të rinjve në proceset e vendimmarrjes në nivel qendror dhe vendor, përmes informimit, zhvillimit të kapaciteteve dhe angazhimit të të rinjve në nisma që adresojnë problematika konkrete në komunitetet e tyre.

Veprimtaritë/idetë e sugjeruara për realizimin e kësaj fushe përparësie përfshijnë (por pa u kufizuar në to):

- Zhvillimin e aktiviteteve të informimit, trajnimit dhe mentorimit të të rinjve për përvetësimin e dijeve qytetare, demokratike dhe aftësive të nevojshme për angazhimin e tyre në proceset vendimmarrëse në nivel qendror dhe vendor, duke u shoqëruar me zbatimin në praktikë të dijeve të përfituara;
- Fuqizimin e strukturave rinore në bashki, si Këshillat Vendor Rinor dhe punonjësit rinor dhe kthimin e tyre në mekanizma efektive për nxitjen dhe zhvillimin e politikave rinore, përmes rritjes së kapaciteteve dhe forcimit të dialogut të strukturuar me të rinjtë, organizatat e shoqërisë civile dhe aktorët e tjerë të komunitetit;
- Nxitja e angazhimit rinor në zbatimin e nismave që adresojnë problematika konkrete në komunitetet vendore përmes organizimit dhe aktiviteteve vullnetare nga vetë të rinjtë;
- Angazhimin e të rinjve në transformimin e qendrave rinore në hapësira miqësore, të hapura, të sigurta dhe të aksesueshme nga të rinjtë, për të siguruar një bazë të qëndrueshme për pjesëmarrjen, ndërveprimin social dhe veprimtarinë e qëndrueshme të të rinjve në komunitetin e tyre;

**Fusha e përparësisë nr 2:** Nxitja e punëve të denja dhe ndërlidhjes së të rinjve me tregun e punës.

Kjo fushë përparësie përfshin mbështetjen e punësimit dhe vetëpunësimit të të rinjve përmes zhvillimit të kapaciteteve dhe orientimit të tyre drejt mundësive më të vlefshme në tregun e punës.

Veprimtaritë/idetë e sugjeruara për realizimin e kësaj fushe përparësie përfshijnë (por pa u kufizuar në to):

- Zhvillimin e aktiviteteve të informimit, trajnimit dhe mentorimit me të rinjtë për të mbështetur aksesin e tyre në sektorët me shkallë të lartë punësimi dhe perspektive zhvillimi bazuar në studimet e tregut të punës, si psh. turizmi, agropërpunimi, energjia, kodimi, programimi kompjuterik, TIK-u etj;
- Mbështetjen e përvetësimit të aftësive të buta nga të rinjtë që lehtësojnë përvojën e punës dhe avancimin e tyre në karrierë si aftësitë e komunikimit, negocimit, lidhshimit, zgjidhjes së konflikteve etj;
- Ofrimin e shërbimit të këshillimit për punësim dhe orientim në karrierë, në mënyrë të personalizuar dhe formë miqësore për të rinjtë, përmes përdorimit të metodave moderne dhe të testuara;

- Nxitja e sipërmarrjes rinore dhe vetëpunësimit të të rinjve përmes aktiviteteve të trajnimit dhe mentorimit në fusha si krijimi i një sipërmarrje, aksesit në grante dhe financime, menaxhimi i fondeve, nxitja e veprimtarisë zejtare etj;

**Fusha e përparësisë nr 3:** Mbështetja e mirëqenies aktive, të shëndetshme, fizike, sociale, kulturore dhe mendore e të rinjve.

Kjo fushë përparësie synon nxitjen mirëqenies aktive, të shëndetshme, fizike, sociale, kulturore dhe mendore përmes aktivizimit të të rinjve, në të gjithë diversitetin e tyre.

Veprimtaritë/idetë e sugjeruara për realizimin e kësaj fushe përparësie përfshijnë (por pa u kufizuar në to):

- Nxitja dhe promovimi i jetesës së shëndetshme dhe mirëqenies mendore, sociale, fizike dhe seksuale tek të rinjtë përmes ndërgjegjësimit, këshillimit, punës rinore dhe vullnetarizmit në çështje që përshijnë mire ushqyerjen, nxitjen e veprimtarive fizike, parandalimin dhe rehabilitimin ndaj të gjitha formave të dhunës, trajtimin e varësive ndaj pirjes së duhanit, drogës, alkoolit dhe lojrave digjitale, shëndetin mendor, shëndetin seksual dhe riprodhues, planifikimin familjar, modelet dhe influencat e dëmshme në rrjetet sociale etj;
- Promovimin e shërbimeve shëndetësore miqësore për të rinjtë dhe nxitjen e aksesit së të rinjve në to;
- Nxitjen dhe mbështetjen e angazhimit dhe krijimtarisë së të rinjve për përçimin e mesazheve dhe promovimin e vlerave për bashkëmoshatarët e tyre përmes zhvillimit të të gjitha llojeve të veprimtarive artistike, kulturore, sociale dhe edukative;
- Angazhimi i profesionistëve të rinj në zhvillimin dhe promovimin e programit Jashtë Orarit Mësimor (JOM) dhe nxitjen e përvojave të reja për fëmijët dhe të rinjtë pjesëmarrës.
- Edukimi dhe promovimi i jetesës së shëndetshme dhe mirëqenies përmes aktivizimit dhe zhvillimit të aktiviteteve sportive me të rinjve.

### **Aspektet ndërdimensionale**

Tërësia e synimeve/veprimtarive së mësipërme duhen reflektuar në projekt-propozime që adresojnë në mënyrë të përshtatshme aspekte si:

- Shpërndarje gjeografike në të paktën 3 bashki (\*për projekt-propozimet e organizatave për të rinjtë);
- Përfshirje të zonave rurale dhe qyteteve të vogla në ndërhyrje;
- Përfshirje apo adresim i nevojave të të rinjve në kushte rreziku, vulnerabiliteti dhe marginalizimi.
- Përfshirje apo adresim i nevojave të të rinjve me aftësi të kufizuara;
- Të rejat duhet të përbëjnë të paktën gjysmën e të rinjve të angazhuar apo përfitues në ndërhyrje.

Fondet do të shpërndahen drejt atyre organizatave, projektet e të cilave kontribuojnë në adresimin e një apo më shumë prioriteteve, që përmbushin kriteret e cilësisë dhe kushtet e tjera të kësaj thirrje publike, sikurse është përcaktuar në Udhëzues.

## **2. Fondi (Grantet) në dispozicion për financimin e projektpropozimeve**

Totali i grantit për mbështetjen e organizatave rinore dhe/ose për të rinjtë në këtë thirrje është 58,000,000 (pesëdhjetë e tetë milion) Lekë.

Vlera e granteve që ndahen si pjesë e kësaj thirrje publike duhet të mos tejkalojë shumën maksimale si më poshtë:

-Shuma maksimale për projekt-propozimet nga organizatat rinore është 1,500,000 (një milion e pesëqind mijë) Lekë

-Shuma maksimale për projekt-propozimet nga organizatat për të rinjtë është 3,500,000 (tre milion e pesëqind mijë) Lekë

Grantet e alokuara në këtë thirrje publike mund të mbulojnë shpenzimet administrative dhe shpenzimet e personelit deri në masën 30% të shumës së kërkuar. Ndërsa, pjesa tjetër prej 70% e fondeve, duhet të parashikohet për aktivitete programore të projektit.

Për secilin projekt, 4 – 6% e vlerës totale të propozuar duhet të parashikohet për aktivitete që lidhen me dukshmërinë/ vizibilitetin.

Agjencia Kombëtare e Rinisë rezervon të drejtën të mos i alokojë të gjitha fondet që ka në dispozicion në rast se projekt-propozimet e paraqitura nuk i plotësojnë kriteret e përcaktuara.

## **3. KUSH MUND TË APLIKOJË**

Pjesëmarrja në këtë thirrje publike është e hapur dhe e barabartë për organizatat rinore dhe organizatat për të rinjtë që janë zyrtarisht të regjistruara dhe në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi në Shqipëri. Kandidatët e mundshëm nuk mund të marrin pjesë në thirrje ose nuk do të financohen me grante nëse nuk dorëzojnë bashkë me projekt-propozimin, dokumentacionin që tregon se:

- a) nuk janë në proces shpërndarjeje ose likuidimi;
- b) nuk kanë detyrime tatimore apo kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të pashlyera;
- c) përfaqësuesi i saj ligjor nuk është i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë.

Kandidatët do të përjashtohen nga pjesëmarrja në thirrje apo nga ndarja e granteve nëse në kohën e dorëzimit të projekt propozimeve:

- janë subjekt i ndonjë konflikti të interesit, sikurse parashikuar në dispozitat e Ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005, i ndryshuar “*Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike*”;

- janë fajtorë për dhënien e informacionit të rremë një pale kontraktuese të autorizuar, që kërkohet si parakusht për pjesëmarrje në thirrjen për dorëzimin e projekt-propozimeve ose nëse nuk dorëzojnë informacionin e kërkuar;
- janë përpjekur të sigurojnë informacion konfidencial, të ushtrojnë ndikim mbi Komisionin e Vlerësimit ose mbi një palë të autorizuar kontraktuale gjatë procesit të vlerësimit të projekt-propozimit;
- nuk kanë dorëzuar të gjitha dokumentet e nevojshme sipas seksionit 8 të këtij Udhëzuesi
- shuma e financimit të kërkuar nga AKR është më e lartë nga 1.500.000 Lekë për organizatat rinore;
- shuma e financimit të kërkuar nga AKR është më e lartë nga 3.500.000 Lekë për organizatat për të rinjtë;
- kohëzgjatja e propozuar e projektit është më e shkurtër se 6 muaj ose më e gjatë se 12 muaj;

#### **4. KOHËZGJATJA**

Kohëzgjatja e projekt-propozimit mund të jetë nga 6 deri në 12 muaj.

#### **5. VENDI I ZBATIMIT**

Projektet duhet të zbatohen ekskluzivisht në territorin e Republikës së Shqipërisë.

#### **6. LLOJET E PROJEKTEVE**

- Projekt-propozimet që do të financohen nga AKR duhet të jenë të përgatitura në përputhje me Thirrjen Publike Nr.3 dhe prioritetet e saj.
- Projektet duhet të ofrojnë zgjidhje për nevojat specifike të grupeve të synuara të identifikuar nga projekti.
- Projektet duhet të jenë paketa veprimtarish të integruara dhe metodologjike, të krijuara për të arritur qëllime të caktuara dhe rezultate specifike në kuadër të një periudhe të kufizuar kohore.

*Aktivitetet në vijim nuk rekomandohen për ndarjen e granteve:*

- Sponsorizimet individuale për pjesëmarrje në seminare, konferenca, kongrese;
- Bursat individuale për studime apo kurse trajnimi;
- Konferenca të herëpashershme (përveç nëse janë të nevojshme për zbatimin e suksesshëm të projektit);
- Financimi i projekteve që tanimë janë në proces ose kanë përfunduar;
- Projektet për përfitime ekskluzive të individëve;
- Blerja e pajisjeve dhe punët rehabilituese/ndërrhyrjet në infrastrukturë përveç rasteve kur janë patjetër të domosdoshme dhe brenda limiteve të shprehura në pikën 2 të Udhëzuesit. (në raste të tilla pajisjet mbeten pronë e AKR deri në momentin kur i dhurohen subjektit);

*Aktivitetet në vijim përbëjnë shkak për refuzimin automatik:*

- Projektet që mbështesin partitë politike;

- Projektet për blerje toke, godine apo zyre;
- Projekte jashtë zonës së mbulimit të projektit në fjalë;

## 7. PARTNERITETET DHE BASHKËPUNIMI .

OJF-të e interesuara mund të aplikojnë në mënyrë individuale ose në partneritet me organizata dhe/ose institucione të tjera.

### *Organizatat partnere*

Partnerë të projektit mund të jenë organizata të tjera rinore ose për të rinjtë. Partnerët e OJF-së kandidatë marrin pjesë në planifikimin e zbatimit të projektit, dhe shpenzimet u nënshtrohen rregullave të njëjta si ato të bëra nga vetë organizata kandidatë. Në këtë mënyrë, organizata partnere duhet të përmbushë kushtet e njëjta të legjitimitetit sikurse edhe organizata aplikuese. Nëse aplikojnë në partneritet, organizata aplikuese do të jetë organizata udhëheqëse dhe në rast të përzgjedhjes, kjo organizatë do të jetë pala kontraktuese (përfituese) dhe do t'i marrë të gjitha përgjegjësitë ligjore dhe financiare për zbatimin e projektit. **Deklarata e Partneritetit** (Shtojca A) duhet të plotësohet në mënyrë korrekte dhe duhet të dorëzohet së bashku me dokumentet e tjera të aplikimit.

### *Bashkëpunëtorët: organizata dhe institucione te tjera*

Organizatat dhe/apo institucionet tjera (p.sh. shkollat, kopshtet e fëmijëve, muzetë, etj) mund të përfshihen në projekt. Subjektet e tilla – bashkëpunëtorët kanë rol të rëndësishëm në zbatimin e aktiviteteve, mirëpo nuk mund të jenë përfitues të grantit.

## 8. DOKUMENTACIONI I NEVOJSHËM PËR TË APLIKUAR

### I. *Dokumentet kryesore:*

- Projekt-propozimi (në formatin word - Shtojca 7);
- Buxheti (formati Excel - Shtojca 8);
- Korniza logjike (formati word – Shtojca 9);
- Plani i aktiviteteve dhe dukshmërisë (formati Excel – Shtojca 10).

### II. *Dokumente shtesë (për organizatën aplikuese dhe organizatën partnere).*

- Kopje e aktit të regjistrimit në gjykatë dhe ekstrakti historik nga gjykata;
- Kopje të statutit të organizatës, ku specifikohet si pjesë e veprimtarisë së saj dhe zhvillimi i aktiviteteve rinore;
- Vërtetim nga gjykata që tregon se organizata nuk është në proces shpërndarje ose likuidimi;
- Vërtetim nga organet tatimore që tregon se organizata nuk ka detyrime tatimore apo kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të pashlyera;
- Vërtetim i gjendjes gjyqësore (dëshmia e penaltetit) ku tregohet që përfaqësuesi ligjor i organizatës nuk është dënuar me vendim të formës së prerë;
- Formulari i kompletuar identifikues administrativ (formati word– Shtojca 11);
- Formulari i kompletuar identifikues financiar (formati word– Shtojca 12);

- Kopje e Pasqyrave financiare të OSHC-së (a. bilanci; b. PASH; c. cash flow; ç. shënimet shpjeguese) për vitin 2022 të firmosur nga një kontabilist i miratuar ose financieri zyrtar i OSHC-së sipas kriterëve ligjore në fuqi. Në rastin që organizata është themeluar gjatë këtij viti nuk është e nevojshme të dorëzohen pasqyrat.
- Një raport përshkrues (CV), i projekteve dhe aktiviteteve të zbatuara nga organizata, ku të evidentohet gjithashtu përvoja me projektet dhe programet me ndikim tek të rinjtë;
- Deklarata e partneritetit në rast se OJF aplikuese ka partnerë (shtojca A);
- Deklarata e shmangies së konfliktit të interesit (shtojca B);
- Deklarata për përqindjen e anëtarëve të rinj, **vetëm për organizatat rinore** (shtojca C).

*Shënim: Me qëllim vlerësimin e projekt-propozimit, dokumentacioni kryesor dhe ai shtesë janë njësoj të vlefshme dhe dorëzimi i të gjitha dokumenteve të sipër përmendura në 3 kopje fizike dhe 1 elektronike (USB) është i detyrueshëm.*

## 9. KUR DHE KU TË MERRET DHE TË DORËZOHET PAKETA E APLIKIMIT

Informacioni përkatës si dhe një version elektronik i të gjithë paketës së aplikimit mund të merret nga faqja e internetit: [www.rinia.gov.al](http://www.rinia.gov.al)

Aplikimet e plotësuara (me të gjithë dokumentet mbështetëse) duhet të dorëzohen **në 3 (tre) kopje fizike dhe 1 (një) kopje elektronike (USB)**, të vendosura në një zarf të vulosur mbi të cilin është shkruar referenca e thirrjes publike, përmes postës zyrtare apo personalisht, gjatë ditëve të punës (e hëne – e premte) gjatë orarit zyrtar, në adresën në vijim:

Agjencia Kombëtare e Rinisë,  
Rruga “Naim Frashëri”, Nr. 37  
Tiranë, Shqipëri

Afati për dorëzimin e aplikimeve është **26.05.2023, ora 16:30**. Në pjesën e jashtme të zarfit duhet të jenë shkruar **emri i Thirrjes Publike Nr.3 për projekt-propozime, emri i plotë dhe adresa e subjektit aplikues** dhe mbishkrimi: **“Të mos hapet përpara hapjes zyrtare”**. Aplikimet e dërguara në mënyra tjera (p.sh. me faks apo e-mail) ose që janë dërguar në adresa të tjera nuk do të merren parasysh.

AKR do të regjistrojë çdo aplikim të marrë në dorëzim dhe do të lëshojë vërtetimin përkatës (datën dhe orën e pranimit të projekt-propozimit).

## 10. INFORMACION TJETËR

Me qëllim mbështetjen e OJF-ve për të paraqitur aplikime në përputhje me kriteret e Udhëzuesit, Agjencia Kombëtare e Rinisë do të organizojë takime informuese dhe ditë të hapura gjatë shkrimit të projekt-propozimit. Më konkretisht:

**Sesionet informuese** (ditët e hapura për më shumë informacion) për këtë thirrje, do të publikohen në website-n zyrtar të AKR-së .



Në rast se kërkohen informacione dhe sqarime shtesë rreth kësaj thirrje, kandidatët e interesuar mund t'i adresojnë përmes adresës info@rinia.gov.al, duke iu referuar thirrjes publike. Pyetjet mund të dërgohen deri më 20.05.2023, ndërsa përgjigjet do të jepen me shkrim brenda 5 ditëve pune që nga data e pranimit të pyetjeve përkatëse ose do të botohen në faqen e internetit të AKR-së.

## 11. VLERËSIMI DHE PËRZGJEDHJA E PROJEKT-PROPOZIMEVE

### *Vlerësimi*

Aplikimet do të shqyrtohen dhe vlerësohen nga Komisioni i Vlerësimit, i cili përbëhet nga pesë anëtarë, të emëruar nga Ministri përgjegjës për Rininë, të përzgjedhur si vijon:

- a) dy anëtarë të caktuar nga Ministri përgjegjës për Rininë, ku njëri luan rolin e kryetarit të komisionit;
- b) një anëtar i caktuar nga titullari i AKR-së;
- c) dy anëtarë ekspertë nga shoqëria civile me ekspertizë në vlerësimin e projekteve zhvillimore dhe me ndikim tek të rinjtë<sup>1</sup>.

*Shënim: OJF-ja, përfaqësuesi i së cilës është anëtar i Komisionit të Vlerësimit në cilësinë e përfaqësuesit të shoqërisë civile, nuk ka të drejtë të aplikojë në këtë thirrje as si aplikant kryesor dhe as si partner.*

*Përfaqësuesi i shoqërisë civile në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit, zgjidhet me një proces të hapur dhe konkurrues.*

Projekt-propozimet me pikët më të larta, do t'i propozohen për miratim Ministrit përgjegjës për Rininë.

Aplikimet do të vlerësohen në bazë të:

#### *(i) Kritereve administrative:*

- Aplikimi është dorëzuar brenda afatit, specifikuar në seksionin 9 të këtij Udhëzuesi;
- Aplikimi është i kompletuar sipas kërkesave të seksionit nr. 8;
- Dokumentacioni është dorëzuar në 3 (tre) kopje të shtypura dhe në 1 (një) kopje elektronike (USB);
- Konfirmimi se organizata aplikuese, partnerët (dhe bashkëpunëtorët, nëse ka të tillë) dhe aktivitetet i përmbushin kushtet e specifikuara në këtë udhëzues.

#### *(ii) Kritereve të përmbajtjes/ vlerësimi i cilësisë së projektit dhe vlerësimi financiar:*

Vlerësimi i cilësisë së projektit, përfshirë edhe buxhetin e propozuar, do të bëhet në përputhje me kriteret e specifikuara në Tabelën Vlerësuese që është pjesë përbërëse e këtij dokumenti.

---

<sup>1</sup> Kur një donator apo grup donatorësh angazhohen të mbështesin thirrjen e AKR-së, ruan të drejtën e propozimit të një anëtari në përbërje të komisionit. Në këtë rast, komisioni do të përbëhet nga gjashtë anëtarë.

### ***Sistemi i vlerësimit është si më poshtë:***

Kriteret e vlerësimit ndahen në seksione dhe nën-seksione: ***Secili nën seksion duhet të vlerësohet me pikët e caktuara nga 1 në 5, në këtë mënyrë: 1= shumë keq; 2= keq; 3= pranueshëm; 4= mirë; 5= shumë mirë.*** Secili anëtar i komisionit plotëson një tabelë individuale vlerësuese dhe të gjithë anëtarët e nënshkruajnë tabelën vlerësuese përmbledhëse për secilin projekt-propozim. Radhitja e projekt propozimeve bëhet në atë mënyrë ku projekt-propozimi i radhitur si i pari është ai i cili kundrejt limitit të kërkuar për segment ka fituar numrin më të lartë të pikëve deri tek projekt-propozimi me numrin më të ulët të pikëve.

- Pikët maksimale të vlerësimit për një projekt – propozim janë 100;

Vendimi për aprovimin e grantit mbështetet mbi numrin e përgjithshëm të projekteve që mund të financohen me buxhetin në dispozicion. Projektet që kanë fituar numër më të madh të pikëve kundrejt limitit të kërkuar për segment do të kenë prioritet gjatë dhënies së granteve.

### ***Shënim për Seksionin 1/ Tabela e Vlerësimit: Kapaciteti financiar dhe operativ i organizatës aplikuese***

Për të kaluar për vlerësim të mëtejshëm, projekti duhet të vlerësohet me 10 ose më shumë pikë, në seksionin 1. Kjo nënkupton që organizatat kanë në dispozicion buxhet të mjaftueshëm për financimin e aktiviteteve të rregullta gjatë gjithë periudhës së zbatimit të projektit si dhe kanë aftësi profesionale dhe kualifikime të cilat janë të domosdoshme për zbatimin e suksesshëm të projektit. E njëjta vlen si për organizatën aplikuese ashtu edhe për partnerët.

Projekti përjashtohet nga procesi i mëtejshëm i vlerësimit në rast se numri total i pikëve të marra në Seksionin 1 është më i ulët se 10 pikë.

### ***Shënim për Seksionin 2/Tabela e Vlerësimit: Relevanca***

Për të kaluar për vlerësim të mëtejshëm, projekti duhet të vlerësohet me 18 ose më shumë pikë, në seksionin 2. Kjo nënkupton që projekti duhet të jetë relevant me qëllimin e Thirrjes Publike Nr.3 dhe fushat prioritare, cilësia e projektit, rezultatet e pritshme dhe qëndrueshmëria e projektit janë të konsiderueshme si dhe fondet që kërkohen janë në përputhje me aktivitetet e parashikuara.

Projekti përjashtohet nga shqyrtimi i mëtejshëm në rast se numri total i pikëve në Seksionin 2 është më i ulët se 18 pikë, sepse pikët tregojnë se megjithëse aplikanti i ka kapacitetet financiare dhe operative, koncepti i projektit nuk është relevant apo në përputhje me përparësitë e përcaktuara në thirrjen publike/ projekti nuk trajton nevojat e komunitetit.

### **Tabela e vlerësimit**

<b>Seksioni</b>	<b>Pikët maksimale</b>	<b>Pikët mesatare</b>
1. Kapacitetet financiare dhe operative	15	
1.1 A kanë aplikanti dhe partnerët përvojë të mjaftueshme në menaxhim projektësh? <i>Vlerësim maksimal marrin organizatat që kanë të paktën 3 projekte të zbatuara apo në zbatim</i>	5	
1.2 A kanë aplikanti dhe partnerët kapacitete të mjaftueshme profesionale? (njohuri specifike në fushën relevante) <i>Vlerësim maksimal marrin organizatat të cilat kanë zbatuar të paktën 3 projekte në fushën për të cilën aplikojnë.</i>	5	

1.3. A kanë aplikanti dhe partnerët kapacitete të mjaftueshme menaxhuese? (përfshirë personelin, pajisjet dhe kapacitetet për menaxhim financiar)? <i>Vlerësim maksimal marrin organizatat të cilat kanë zbatuar të paktën 3 projekte me shuma mbi 10.000 Euro.</i>	5	
<b>2. Relevanca</b>	<b>25</b>	
2.1. Sa relevant është projekti krahasuar me synimin dhe me një apo më shumë përparësi të përcaktuara në thirrjen publike? Shënim: 5 pikë (shumë mirë) mund të jepen vetëm nëse projekti trajton të paktën njëren prej përparësive të bëra publike në thirrjen e shpallur	5	
2.2 A janë palët e interesuara të përcaktuara qartë dhe të përzgjedhura në mënyrë strategjike (bashkëpunëtorët, përfituesit përfundimtarë, grupet e synuara)?	5	
2.3 A janë nevojat e grupit të synuar dhe përfituesve përfundimtarë të përcaktuara qartë dhe a i trajton projekti ato në mënyrën e duhur?	5	
II.4 A përfshin projekti vlerë të shtuar, si qasje inovative dhe modele të praktikës së mirë? <i>Vlerësim maksimal marrin aplikimet të cilat sjellin risi në zbatimin e projekteve në bashkinë përkatëse.</i>	5	
I.4 A bën projekti advokim për një qasje të bazuar tek të drejtat dhe a ka ndikim pozitiv tek grupet e pafavorizuara? (fuqizim i të rejave, aktivizimi i të rinjve në zona rurale dhe bashki të vogla, mbështetje e të rinjve në kushte rreziku, vulenrabiliteti, me aftësi të kufizuara , etj.) <i>Vlerësim maksimal marrin aplikimet, të cilat ndikojnë në të paktën 2 grupe të marginalizuara</i>	5	
<b>3. Metodologjia</b>	<b>20</b>	
3.1 A përshtaten plani i aktiviteteve dhe aktivitetet e propozuara në mënyrë logjike dhe praktike me qëllimet dhe rezultatet e pritshme?	5	
3.2 Sa konsistente është skema e përgjithshme e projektit? (veçanërisht, a e pasqyron analizën e problemeve të identifikuara, faktorët e mundshëm të jashtëm) <i>Vlerësim maksimal marrin aplikimet, në të cilat janë marrë në konsideratë faktorët e jashtëm (sipas logframe) dhe janë prezantuar masa për eliminimin e tyre.</i>	5	
3.3 A është i kënaqshëm niveli i përfshirjes së partnerëve në zbatimin e projektit? Shënim: nëse nuk ka asnjë partner pikët e përfituara do të jenë 1. <i>Këtu nuk përfshihen bashkëpunëtorët.</i>	5	
3.4 A janë përfshirë në projekt tregues objektivisht të matshëm? <i>Vlerësim maksimal marrin aplikimet, të cilat në logframe kanë indikatorë të qartë e të matshëm.</i>	5	
<b>4. Qëndrueshmëria</b>	<b>25</b>	
4.1 A do të kenë veprimtaritë e propozuara ndikim konkret tek grupet e synuara? <i>Vlerësim maksimal marrin aplikimet të cilat lidhin aktivitetet e propozuara me grupet e synuara.</i>	5	
4.2 A do të ketë projekti ndikime të shumëfishta? (përfshirë mundësinë e zbatimit në grupe të tjera të synuara ose në vende të tjera dhe/ose shtrirjen e ndikimit të veprimtarive si dhe shkëmbimin e informacionit për përvojën e fituar gjatë zbatimit të projektit)	5	
4.3 A janë rezultatet e pritshme të veprimtarive të sugjeruara të qëndrueshme nga ana institucionale? (a do të ekzistojnë strukturat që mundësojnë veprimtaritë e projektit pas përfundimit të projektit? A do të ketë pronësi mbi rezultatet e projektit?)	5	
4.4 A janë rezultatet e pritshme të qëndrueshme? (aty ku është rasti, përmendni ndikimin strukturor të veprimtarive të zbatuara – përmirësimet në kuadrin ligjor, metoda, kodin e sjelljes, etj.)	5	
4.5 A ka mundësi që rezultatet/arritjet e pritshme afatgjata do të ndikojnë në kushtet ekonomike dhe/ose cilësinë e jetës në zonën e synuar?		
<b>5. Buxheti dhe efikasiteti i kostos</b>	<b>15</b>	
5.1 A është i kënaqshëm raporti ndërmjet shpenzimeve të parashikuara dhe rezultateve të pritshme? <i>Vlerësim maksimal marrin aplikimet të cilat kanë respektuar ndarjen e % së aktiviteteve sipas udhëzuesit.</i>	5	
5.2 A është kostoja e sugjeruar e nevojshme për zbatimin e projektit?	5	
5.3 Buxheti	5	
- a është buxheti i qartë dhe a përfshin edhe pjesën përshkruese? (përfshirë shpjegimet për pajisjet teknike)		
- a përmbushet parimi që kostoja administrative dhe e personelit nuk mund të jetë mbi 30 për qind e buxhetit total?		
- a është buxheti me ndjeshmëri gjinore?		
- a janë përfshirë CV-të dhe përshkrimet e punës, aty ku është e nevojshme?		
<b>Pikët totale maksimale</b>	<b>100</b>	

## ***Njoftimi rreth vendimit***

Në çdo rast, nëse projekt-propozimet e tyre miratohen për financim apo jo, të gjithë aplikantëve iu njoftohet me shkrim vendimi për projekt-propozimin e tyre brenda 45 ditë kalendarike nga mbyllja e thirrjes publike. Rezultatet shpallen në website-n zyrtar: [www.rinia.gov.al](http://www.rinia.gov.al).

Vendimi për refuzimin e projekt-propozimit apo për mosdhënie fondesh merret nëse:

- Organizata kandidate, apo/dhe një ose më shumë partnerë të saj, nuk i përmbushin kushtet e thirrjes publike;
- Aktivitetet e projektit janë të papranueshme (p.sh. aktivitetet e propozuara tejkalojnë fushë-veprimin e thirrjes publike për projekt-propozime, kohëzgjatja e parashikuar e projektit tejkalon kohën maksimale të lejuar, shuma e kërkuar e fondeve tejkalon shumën e lejuar maksimale, dhe/apo shuma e kërkuar e fondeve është më e vogël se minimumi i lejuar, etj);
- Projekt-propozimi nuk ka qenë relevant mjaftueshëm; kapacitetet financiare dhe operative të organizatës aplikuese nuk janë të mjaftueshme, apo projektet e përzgjedhura për financim kanë marrë vlerësim më të lartë në këto aspekte;
- Cilësia e projekt-propozimit ka qenë teknikisht dhe financiarisht më e ulët në krahasim me projektet e përzgjedhura për financim.

AKR-ja njofton kandidatin të përzgjedhur jo fitues mbi rezultatin e vlerësimit, hapat për të kërkuar arsyetimin e vendimit dhe procedurën e ankimit.

## ***Kushtet rreth zbatimit të projektit pas miratimit të grantit***

Pas marrjes së vendimit për miratimin e grantit, organizatës jofitimprurëse, projekti i së cilës është miratuar, i ofrohet një kontratë për zbatimin e projektit. Para se të nënshkruajë kontratën dhe nëse është e nevojshme, organizatës mund t'i kërkohej të ndërmarrë modifikime të caktuara në projekt për ta harmonizuar atë me rregullat dhe procedurat e zbatimit të projektit. Më konkretisht, kur projekt-propozimi është përzgjedhur me kusht, AKR-ja i kërkon kandidatin miratimin e tij, brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike, për reflektimin e rekomandimeve të Komisionit të Vlerësimit për rishikimin e projekt-propozimit. Kandidati që nuk shprehet brenda këtij afati apo refuzon të rishikojë projekt-propozimin bazuar në këto rekomandime, skualifikohet dhe humb të drejtën e mbështetjes me fondet grant për rininë. Në këtë rast, AKR-ja njofton kandidatin pasardhës në listë dhe e fton në procesin e negocimit në përputhje me parashikimet e këtij neni.

Agjencia Kombëtare e Rinisë pasi përfundon procedurën e negocimit me çdo kandidat të përzgjedhur për financim, përcjell për miratim pranë ministrit përgjegjës për rininë listën e rishikuar me projektet fituese, përshkrimin e projekteve dhe shumat përfundimtare të granteve për financim.

## **LISTA E SHTOJCAVE**

**Shtojca 7** Projekt-propozimi

**Shtojca 8** Buxheti

**Shtojca 9** Korniza logjike

- Shtojca 10** Plani i aktiviteteve dhe dukshmërisë
- Shtojca 11** Formulari i identifikimit administrativ
- Shtojca 12** Formulari i identifikimit financiar
- Shtojca 13** Lista e kontrollit
- Shtojca A** Deklarata e partneritetit
- Shtojca B** Deklarata për shmangien e konfliktit të interesit
- Shtojca C** Deklarata për përqindjen e anëtarëve të rinj (për organizatat rinore)